



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.492/1 prot:

Pukë, më 25.03.2026

VENDIM

Nr. 18 datë 25.03.2026

“PER ZGJEDHJEN E SEKRETARIT TE KESHILLIT BASHKIAK PUKË”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës **25.03.2026**, mbeshtetur në ligjin Nr.139/2015 2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" neni 53,pia 3,shkronja “a” si dhe te nenit 56 te VKB nr 14 date 30.06.2020 “Rregullore e funksionimit te Keshillit Te Bashkise Puke” ,neni 16 pika 5 ,neni 19 pika 1,pas lirimit nga detyra te sekretarit z. Hazbi Terbuni vleresoi propozimin per sekretar te keshillit bashkiak me votim te fshehte dhe në perfundim :

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e Sekretarit te Keshillit Bashkiak z.Ndriçim Asllanaj .
2. Funkzioni dhe marredheniet e punes i fillojne me date 01.05.2026.
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Keshillit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika6,e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
5. Vendimi u shpall me datë **25.03.2026**
Vota te vlefshme gjithsej: 11
Vota Pro 10, Vota Kundër 1 , Vota Abstenim 0

SEKRETAR

Hazbi **TERBUNI**

KRYETARI I KESHILLIT

Gjon **GJOKA**

07.04.26

seks. IC rrethit
S. Jany
pen i nft
duda

Keshilli
492/3
03.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

237/1
Nr. prot.

Shkodër, më 01.04.2026



LËNDA: Mbi vendimin nr.18, datë 25.03.2026 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLIT BASHKIAK PUKE

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54/c, neni 55/3, neni 57/1, Udhërit të Kryeministrit nr.21/2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.39/2025 “Per miratimin e rregullores se brendshme “Per organizimin dhe funksionimin e Institucionit te Prefektit te Qarkut”, si dhe aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, neni 19/1 i VKB Pukë Nr.14 datë.30.06.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin Këshillit Bashkiak Pukë”, Shkresës të Sekretarit të Këshillit Bashkiak Puke Nr.466/4prot datë 26.03.2026 “Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Pukë të datës 25.03.2026”, Analizoi VKB Pukë Nr.18 datë.25.03.2026 “Mbi zgjedhjen e sekretarit të Këshillit Bashkiak Puke Z.Ndriçim Asllanaj, (pas daljes në pension) të Z.Hazbi Tërbuni”.

Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI

Holta DUDA